

Ligjëratë: Për plotfuqinë filozofike mendore

Mendime të rralla për filozofin, politikëbërësin dhe ideologjinë

Fatkeqësisht, të menduarit është një produkt për të cilin nuk ka kërkesa të mëdha për furnizim. Të menduarit është një dialog i heshtur me vetveten, fuqia e të cilit mund të përmblihet në fjalinë pasuese: Vetëm dikush që flet me vetveten do të shqetësohet se duke vepruar në kundërshtim me rregullat etike do të bashkëjetojë me një kriminel

RORY J. CONCES

Prolog

Herët në mëngjes fillova të lexoja "Të bijën e Agamemnonit" të Ismail Kadaresë dhe pashë se ai kishte përdorur fjalën "kalimtar" që do të ishte edhe shprehja relevante për prezantimin e sotëm. Duke ditur se do të vija në Ballkan, nisa të lexoja edhe një tjetër vepër letrare, atë të Stieg Larssonit, "Vajza me tatu të dragoit". Sikurse te vepra e Kadaresë, edhe në librin e Larssonit gjeta diçka që do të më hynte shumë në punë, që do të ishte relevante për diskutimin tonë të ditës së sotme. Prandaj ju sot do të jeni shtegtarë të ideve, të mishëruar në një farë udhëtimi topografik. Unë do t'ju shpie nëpër një numër të madh personazhesh (karakteret fiktive dhe historike) dhe nëpër ide, secila prej të cilave na del para sysh, por kur bashkohet me tjera, shfaqet përvorjat tona. Kur t'i vihet kapaku gjithë kësaj që do të shpjegojë, do t'ju familjarizojë me bindjen se plotfuqia mendore filozofike është më shumë se një bashkudhëtar në përvorjat tona jetësore, veçanërisht brenda politikëbërjes.

Mikael Blomkvist dhe formimi i opinionit

Po fillojmë me Mikael Blomkvistin, një karakter fiktiv në veprën e Stieg Larssonit, "Vajza me tatu dragoi" (2005). Më lejoni t'u referohem disa paragrafëve të veprës së tij. Larsson shkruan:

Kapitulli i parë ishte një lloj shpallje e luftës në të cilën Blomkvist nuk i zgjedh me kujdes fjalët. Në njëzet vjetët e fundit, gazetarët financiarë suedezë kishin filluar të shndërroheshin në një grup servilësh jokompetentë të cilin ishin vetëmashtruar me ndjenjën e të qenët të rëndësishëm dhe nuk njiheshin për mendime kritike. Ai kishte nxjerrë këtë përfundim pasi kohë pas kohe, pa menduar dy herë, shumë prej tyre kishin marrë komunikatat e shefave ekzekutivë financiarë dhe spekulantët e tregjeve të stoqeve, dhe i kishin përpunuar, madje edhe në raste kur e dinin se shumë prej informatave çonin në qorrsohak. Këta ishin gazetarë të cilët ose ishin aq naivë, ose kishin marrë detyra të caktuara, apo ishin edhe njerëz që me vetëdije të plotë kishin tradhtuar funksionin e të qenët gazetar...

Ai pikuroi një pikurë të një britme që do të rezultonte nëse një korrespondent do të fillonte në mënyrë jokritike të riprodhonte rastin e një hetuesi sikurse e vërteta e absolute në gjykim vrasësi, pa u konsultuar me argumentet e mbrojtjes ose pa intervistuar familjen e viktimës para se të formonte opinionin se çfarë ishte e drejtë dhe çfarë e padrejtë.

Asaj që i bien fort këta paragrafë është pranimi i rëndësishëm të integritetit gazetaresk dhe formimi i opinionit (doxa). Blomkvist duket se është një shembull i funksionit gazetaresk të një reporterit ose një korrespondenti. Në përfundim të librit të tij, karakteri fiktiv Blomkvist parashtron "mandatin gazetaresk normal" për të "kryer hetime kritike dhe të gjetura objektive para lexuesve". Kjo tregon më shumë rëndësinë e formimit të opinionit sesa me të vërtetën. Mjaft interesante, kjo është në kundërshtim të plotë me qasjen e Platonit,

që është një mohim i opinionit për standarde absolute. Po ashtu joplatonik, Blomkvist duket më shumë sokratic, që do ta bënte edhe karakterin fiktiv edhe atë historik edhe interesant, edhe angazhues.

Sokrati: Diskutimi, të menduarit dhe plotfuqia filozofike

Karakter i radhës është Sokrati. Do t'u kthehem filozofëve Gregory Vlastos dhe Hannah Arendt për të hedhur dritë mbi filozofin grek të shekullit të pestë. Vlastos rrah fort diskutimin se Sokrati i "Apologjisë" së Platonit është një që "futet nën lëkurë të njerëzve" nëpërmjet metodës së përgënjeshtimit. I njohur si një kritik destruktiv i lë ndërlidhësit e tij me argumente "të përmbytura", duke mos lënë i sigurt nëse mund të shpëtohej diçka. Por Sokrati po ashtu është kërkuesi ose hetuesi, që pranon zotërimin e "dijes", dhe duke vepruar kështu, e bën të qartë se në çfarëdo që ai beson mund edhe më tej të ekzaminohet.

Arendt, duke zgjeruar tablonë tonë të Sokratit, një filozof, po ashtu i jep zemër mirëkuptimit tonë për filozofin në përgjithësi, se është dikush që angazhohet në aktivitete të shqyrtimit të mendimeve dhe në të menduar.

Shqyrtimi i menduar (aktiviteti stereotipik i filozofit) çon në argumente bindëse, që karakterizohen nga premisa të vërteta, me vlefshmëri logjike deduktive ose fuqi induktive, dhe me një mungesë të ekuivokëve. Pavarësisht se na pëlqen a po jo, duket se tërhiqemi nga një besim joshës në shqyrtim të arsyeshëm, që reflektohet në pretendimit themelor të Ndrçimit se arsyeja do të në çlirojë.

Jurgen Habermas beson se shqyrtimi i menduar mirë mund të çojnë në rrugë të arsyeshme dhe në vendime të drejta. Ne si qenie njerëzore mund të bashkohemi dhe me gjakftohësi e arsye mund ta çojmë veten drejt një bote më të mirë. Megjithatë, Arendt thekson se arsyeshmëria nuk është një garantues i një jete paqësore dhe prosperuese. Për këtë mohim ka edhe argumente të shumta historike. Ajo për shembull merr si rast arsyetimin e terrorit dhe torturës që ka marrë jetë në mendjet e sulmuesit vetëvrasës dhe tek zyrtarët shtetërorë, respektivisht. Si rezultat i kësaj shprehje njerëz të thjeshtë fillojnë të arsyetojnë veten për gjëra që do të ishin të pamenduara.

Një tjetër aktivitet në të cilin angazhohet filozofi është të menduarit, për të cilin Arendt beson se është burimi i vetëm kundër djallit. Fatkeqësisht, të menduarit është një produkt për të cilin nuk ka kërkesa të mëdha për furnizim. Në fakt, Arendt mendon se ajo çfarë e karakterizon më së shumti epokën tonë është të mosmenduarit. Adolf Eichmann, për Arendtin, ishte një person i shkujdesur. Të menduarit është një dialog i heshtur me vetveten, fuqia e të cilit mund të përmblihet në fjalinë pasuese: Vetëm dikush që flet me vetveten do të shqetësohet se duke vepruar në kundërshtim me rregullat etike do të bashkëjetojë me një kriminel.

Dy forma të të menduarit

Ka dy forma të të menduarit: përpjekja për të pranuar realitetin e Tjetrit dhe përpjekja për të demonstruar empati, kjo e fundit kërkon imagjinim të Tjetrit. Atëbotë Arendt

mohonte empatinë, sepse mendonte se ishte një përpjekje e pamundshme të njohësh atë që s'mund të njihet – çfarë do të ishte sikur të ishte një person tjetër. Është e pamundur, sepse nuk mund të jenë dy persona në të njëjtën kohë. Në kohë të ndryshme, megjithatë mendonte se euptatia ishte diçka e ndryshme, dhe këtë e marr unë si empati. Pra, merrni në konsideratë se si "Unë" do të ndihesha dhe si do t'ia dilja "Unë" të isha në kushte dhe rrethana të tjetrit.

Arendt mendonte se shembulli i mendimtarit nuk ndryshonte asgjë me Sokratin, i cili u kishte kërkuar qytetarëve të mendonin dhe të ekzaminonin; të ekzaminonin paragykimet.

Të menduarit i çliron qeniet njerëzore nga tirania e mishëruar në fara dhe formulon rregullat e sjelljes. Në thelb është negativ dhe nuk është burim i aksiomave morale ose sugjerimeve. Në asnjë formë nuk sjell një kod të sjelljes. Nuk ka për qëllim të na shkatërrojë ose transcendojë opinionin, por diçka "me të cilin duhet të merremi", me qëllim që njerëzit mund të qartësonin perspektivat e tyre dhe të përmirësojnë opinionet e tyre. Sjell një të vërtetë të fuqishme duke mos



shkatërruar opinionin, por duke shpërfaqur opinionin në plotvërtetësinë e tij. Prandaj, ka vazhdimësi ndërmjet të vërtetës, perspektivës dhe opinionit.

Të menduarit është themelor edhe në momente të urgjencës edhe në momente të mundësisë. Momente të urgjencës janë ato kur secili zhvendoset prej atyre që tjetri mund të veprojë ose të besojë. Momente të mundësisë janë ato në të cilat në mënyrë radikale bëhen të mundshme fillime të reja. Unë mendoj se të dyja këto lloje momentesh janë aktuale në Kosovë.

(Vazhdon në numrin e ardhshëm)

(Autori është ligjërues në Departamentin e Filozofisë dhe të Religjionit në Universitetin e Nebraskas në Omaha)

Dokufilm

"Jeta sipas Ion B."

Për mua është një mënyrë për të eksploruar pyetjen se çka është arti në formën e tij të pastër dhe atë çka është një artist i pastër, thotë regjisorin Alexander Nanau

KRESHNIK BERISHA

Jeta e një varfanjaku në moshë të thyer, që zgjohet nga rrapëllimat e mbeturinave që fluturonin nga katet e banesave dhe ngrysej me raki, nën atë qiell të hapur të sokakëve të Bukureshtit, shfaqet qindra kilometra larg, nën qiellin e hapur në Prizren, në natën e katërt të "Dokufestit".

Ion B. nuk e kishte menduar, ndonëse në kinemanë mbi lumë 1 orë rrafsh u shfaq "bota sipas tij", se do të vinte dita që veprat e tij do të ngjallnin interes në botë, në këtë rast, në Ballkanin ish-komunist, i cili mund t'ia kuptojë dhembjen më mirë se të tjerët; arratisjen nga fshati dhe nga babai komunist, dhe të bashkëndiejë me të mjerimin dhe poshtërimin që i solli fati.

Meqë një pjesë të madhe të jetës e kaloi në kontejner, me një mace dhe një jastëk, megjithatë nuk e mbante mend kur ishte nervozuar për herë të fundit.

Këtë e thoshin edhe fqinjët e tij (me atë dozë humor) që flinin si njerëz nëpër apartamente. "Ai ishte i vetmi njeri në botë që jetonte ashtu siç donte". E pra, ai ishte i lumtur. Edhe para se t'i binte fama kresë, siç shprehet ai, në filmin dokumentar mbresëlënës, "The world according to Ion B." të regjisorit rumun Alexander Nanau.

Pse Ion Barladeanu? Sepse ai është një artist i madh bashkëkohor.

Ion B. deri para 2 vjetësh ishte një i pastrehë që flinte në një dyshek në mbeturinat e një blloku. Sikurse njerëzit që mbajnë qen dhe mace nëpër shtëpi, unë vendosa të mbaj një njeri, dhe e lash të banonte në këtë hapësirë, thotë njëri prej banorëve të bllokut. Derisa një ditë e viziton Dan Popescu një djalë i ri, pronar i një galerie, dhe i mahitur nga punimet e tij, e nis drejt aventurave

të panjohura për plakun 62-vjeçar, i cili nuk dëshiron të jetë i pasur, por vetëm të ketë një biçikletë, duke na e kthyer shpeshherë tragjedinë e vet në shpërthime të qeshurash.

Për 1 vit e 2 muaj ekipi i të rinjve i ndenji pranë plakut që i pëlqente ta quante veten regjisor. Arti i tij bëhej nga prerja e fotografive të personaliteteve të famshme të kohës, nga revistat që i gjente në kontejnerë, për t'i vendosur në situata të çuditshme përplot humor të zi, të cilat i ruante me dekada me të vetmen ndjenjë kujdesi që i kishte mbetur.

"Ai bëri atë që, sipas mendimit tim, në mënyrë metaforike apo fjalë për fjalë, çdo artist duhet ta bëjë: të marrë rrugën e rrezikshme në tokë që asnjë njeri nuk i shkon dot", thotë i riu Dan Popescu. "Kur pashë për herë të parë pikturat e Ion Barladeanu, më impresionoi kualiteti kinematografik i tyre.

Kur e dëgjova rrëfimin e jetës së tij, vendosa të eksploroja personalitetin dhe punën e këtij artisti të vetëmësuar e të rrallë, që vepronte në nëntokën e një regjimi totalitar", shprehet regjisorin Alexander Nanau. "Jeta sipas Ion B." për mua është një mënyrë për të eksploruar pyetjen se çka është arti në formën e tij të pastër dhe atë që është një artist i pastër, thotë Nanau.

E sa janë gjasat që artisti Ion B. të vjen me një ekspozitë në Kosovë, regjisorin Nanau tek i përgjigjej pyetjeve me t'u ndezur dritat në kinemanë mbi Lumbardh, e la të hapur këtë mundësi duke shtuar se kjo varet prej nesh, kosovarëve. Ndërsa rreth asaj se në çfarë kushtesh jeton tashmë artisti pas famës së arritur dhe sa është i pasur, Nanau tregoi se pikturat e Ion B. tashmë shiten prej 2 deri në 3 mijë euro, ndërsa në sirtarin e tij ka rreth 2 mijë sosh.